



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

Nr. 219, datë 12.10.2016

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E LICENCËS KOMBËTARE TË
TRANSMETIMIT AUDIOVIZIV DHE LICENCËS KOMBËTARE TË SHËRBIMIT TË
PROGRAMIT AUDIOVIZIV”**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1/ë dhe 16 dhe nenit 70 e vijues të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënie e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Piro

MISHA

Suela

MUSTA

Zylyftar

BREGU

DRAFT RREGULLORE

PËR

KRITERET DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E LICENCËS KOMBËTARE TË TRANSMETIMIT AUDIOVIZIV DHE LICENCËS KOMBËTARE TË SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV

KREU I

TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat e licencimit për dhënie e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv mbështetje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Rregullat, kriteret dhe procedurat e parashikuara në këtë rregullore do të zbatohen vetëm për dhënie e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv.

Neni 3

Baza Ligjore

1. Licencimi sipas kriterëve dhe procedurës së përcaktuar në këtë rregullore bazohet në aktet e mëposhtme ligjore:
 - a. Ligji nr. 9851 datë 26.12.2007 "Për ratifikimin e akteve finale të konferencës rajonale të radio-komunikacioneve për planifikimin e shërbimit të transmetimit numerik tokësor në pjesë të rajoneve 1 dhe 3, në bandat e frekuencës 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06) dhe të akteve finale të konferencës rajonale të radiokomunikacioneve për rishikimin e marrëveshjes së Stokholmit, 1961 (RRC-06 REV. ST 61), të zhvilluar në Gjenevë, 15 maj - 16 qershor 2006.
 - b. Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"

- c. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012 “Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike”.
- d. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 466 datë 27.02.2013 “Për miratimin e planit kombëtar të frekuencave”.

Neni 4

Përkufizime

- 1. Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, dhe në rast se nuk janë të përkufizuar në ligj, do të jenë në përputhje me direktivat e BE-së dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi në fushën e mediave audiovizive.
- 2. Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a. “AMA” është Autoriteti i Mediave Audiovizive.
 - b. “Subjekti aplikues” është personi juridik i organizuar në formën e shoqërisë aksionare i regjistruar në Republikën e Shqipërisë me objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive, i cili aplikon për marrjen e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe shërbimit të programit audioviziv.
 - c. “Akses i kushtëzuar” është çdo masë dhe/ose rregullim teknik që mundëson marrjen në formë të kuptueshme të shërbimeve të mbrojtura, kundrejt një autorizimi individual paraprak. Aksesit i Kushtëzuar është një shërbim ndërmjetës që realizon abonimin në shërbimet televizive. Ai mund të kërkohej edhe nga shërbimet pa pagesë (free-to-air).
 - d. “Pajisje e ndaluar” është çdo pajisje ose program i projektuar ose i përshtatur për dhënien e aksesit në një shërbim të mbrojtur në një formë të kuptueshme, të qartë, pa autorizimin e ofruesit të shërbimit.
 - e. “Program televiziv” është tërësia e imazheve lëvizëse, me ose pa zë, që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filma, ngjarje sportive, komedi, dokumentarë, programe për fëmijë dhe drama origjinale.
 - f. “Programe në gjuhën shqipe” janë programe të prodhuara në gjuhën shqipe, përmes titrimit të programeve të huaja në gjuhën shqipe ose përkthimit të tyre me zë në gjuhën shqipe.
 - g. “Shërbimi mediatik audioviziv” është një shërbim nën përgjegjësinë editoriale të një operatori të shërbimit mediatik, qëllimi kryesor i të cilit është ofrimi i programeve informuese, argëtuese ose edukuese, për publikun e gjerë, nëpërmjet rrjeteve të komunikimit elektronik. Një shërbim i tillë mediatik audioviziv është ose një transmetim televiziv ose një shërbim mediatik audioviziv, sipas kërkesës dhe/ose një komunikim tregtar audioviziv, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
 - h. “Shërbimi televiziv me ekran të gjerë” është një shërbim televiziv që konsiston tërësisht ose pjesërisht në programe të prodhuara për t’u shfaqur në një format me ekran të gjerë. Formatit referencë për shërbimin e televizionit me ekran të gjerë është formati 16:9.
 - i. “Transmetim pa pagesë” është transmetimi, për marrjen e të cilit nuk i paguhet tarifë subjektit (mbajtës të së drejtës) që e siguron këtë shërbim mediatik audioviziv.

- j. "Transmetim jolinear" është ofrimi i shërbimit të programit audioviziv për marrje, sipas kërkesës individuale dhe në momentin e zgjedhur nga përdoruesit.
- k. "Transmetim linear" është ofrimi i shërbimit të programit audioviziv për marrje të njëkohshme të tyre nga dëgjuesit dhe/ose shikuesit.
- l. "Transmetimi televiziv" është transmetimi linear i një shërbimi audioviziv, i siguar nga OSHMA për shikimin e njëkohshëm të programeve, mbi bazën e një skeme programesh.
- m. "Shërbim programor i përgjithshëm" është shërbimi programor me përmbajtje të shumëllojshme, i cili mund të jetë kombëtar, rajonal ose lokal.
- n. "Shërbim programor tematik" është shërbimi programor që të paktën 70% të kohës së transmetimit ia dedikon përmbajtjeve mbi një tematikë të caktuar: informacion; të mitur; kulturë dhe shkencë; filma; sport; shqip; muzikë, etj.
- o. "Shërbim programor për të mitur" është shërbimi programor tematik me përmbajtje që i dedikohen grupmoshës deri në 18 vjeç, me qëllim, informimin, edukimin dhe argëtimin, duke respektuar liritë dhe të drejtat e tyre.
- p. "Shërbim programor informativ" është shërbimi programor tematik me përmbajtje dedikuar informacionit, me lajme, rubrika të aktualitetit, kronika, reportazhe, debate dhe lidhje të drejtpërdrejta, biseda apo forume mbi aspekte të ndryshme të zhvillimit social, ekonomik, politik, kulturor etj.
- q. "Shërbim programor kulturë dhe shkencë" është shërbimi programor tematik me përmbajtje edukative, historike, artistike, letrare ose shkencore, dokumentarë dhe emisione të aktualitetit shkencor dhe teknologjik, me karakter argëtues, vepra audiovizive evropiane, pjesë teatrale, lirike etj.
- r. "Shërbim programor film" është shërbimi programor tematik i dedikuar për transmetimin e filmave artistikë, televizivë, seriale, etj.
- s. "Shërbim programor muzikë" është shërbimi programor tematik i dedikuar të gjitha rrymave krijuese e interpretuese, me përmbajtje të regjistruara ose live, informacion dhe diskutime mbi ngjarje muzikore nga vendi e bota etj.
- t. "Shërbim programor sport" është shërbimi programor tematik i dedikuar sportit, me ngjarje lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare të transmetuara direkt ose të regjistruara, lajme dhe emisione diskutimesh nga zhvillime të ndryshme sportive.
- u. "Shërbim programor shqip" është shërbimi programor tematik me programe tërësisht në gjuhën shqipe, për nxitjen dhe promovimin e gjuhës e kulturës kombëtare, si filma, dokumentarë, përmbajtje zbavitëse e argëtuese etj.
- v. "Shërbim programor teleshitje" është shërbimi programor tematik që përbën një ofertë të drejtpërdrejtë për publikun për shitjen apo sigurimin e mallrave, shërbimeve ose pasurive të tjera të paluajtshme apo pronësisë intelektuale.
- w. "Shërbime të reja shoqëruese" janë shërbimet që ofrohen si pasojë e zhvillimeve të reja teknologjike, si: PVR, PVOD, Catch-Up, Time Shifting, EPG/Audio/Titra shumë gjuhësore, përditësime OTA, etj.
- x. "Udhëzuesi elektronik i programit" është mënyra elektronike e informimit të publikut lidhur me listën dhe orarin e programeve nga shërbimi i transmetimit, e cila është pjesë përbërëse e sistemit të transmetimit.

Neni 5

Llojet e licencave

1. Llojet e licencave që jepen në zbatim të kësaj rregullore janë:
 - 1.1. Licencë kombëtare transmetimi audioviziv që përbëhet nga:
 - a. licenca të shërbimit të programi audioviziv,
 - b. licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit numerik
 - 1.2. Licencë kombëtare shërbim programi audioviziv për ofrimin e një shërbimi programi audioviziv
2. Të drejtën e aplikimit për t'u pajisur me licencë rrjeti numerik kombëtar e kanë subjektet që:
 - a) zotërojnë licencë kombëtare për shërbime programi audioviziv;
 - b) nuk zotërojnë licencë për shërbime programi audioviziv. Në këtë rast aplikimi bëhet njëkohësisht për licencë për shërbime programi.

Neni 6

Karakteristikat e rrjeteve kombëtare private numerike, struktura e shërbimeve të programeve që mbështeten në to

1. Rrjetet kombëtare private numerike kanë karakteristikat e mëposhtme:

Gjerësia e bandës	8 MHz
Brezi i frekuencave	470-790 MHz
Teknologjia	DVB-T2
Sistemi i Kodimit	MPEG-4
Cilësia e transmetimit	SD/HD

2. Struktura e shërbimeve të programeve që do të mbështeten në rrjetet kombëtare private numerike ka përbërjen e mëposhtme:

	KARAKTERI I PROGRAMIT	PROGRAME TE VETA
1	I përgjithshëm	Jo me pak se 1 program
2	Të mitur	Jo me pak se 1 program

3	Sport	Jo me pak se 1 program
4	Filma	Jo me pak se 1 program
5	Shqip	Jo me pak se 1 program
	Totali	5

2.1. Përveç programeve të mësipërme, aplikuesit kanë të drejtë të mbështetin në rrjetin kombëtare private numerike edhe programet e veta të mëposhtme:

NR	KARAKTERI I PROGRAMIT
1	Program informativ
2	Program për të rritur
3	Program kulturë dhe shkencë
4	Program mode
5	Program sipas kërkesës
6	Teleshitje
7	Program reality show
8	Muzikë
9	Programe të tjera

Neni 7

Shfrytëzimi i rrjeteve

1.Subjekti i cili do të licenohet për transmetime kombëtare audiovizive, ka të drejtë të shfrytëzojë deri në 60% të kapacitetit transmetues të rrjetit numerik për mbështetjen e programeve të veta.

2. Subjekti që do të licenohet për transmetime numerike kombëtare audiovizive është i detyruar t'i japë akses në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jo diskriminuese, në jo më pak se 40 % të kapacitetit të rrjetit numerik të tij, OSHMA-ve që zotërojnë licencë kombëtare shërbimi programi audio dhe/ose audioviziv. Kushtet e shfrytëzimit të jo më pak se 40% të kapacitetit të rrjetit numerik, në rast të mungesës së kërkesë nga OSHMA-të, do të

rregullohet me vendim të veçantë të AMA të marrë më shumicë të cilësuar të anëtarëve të tij.

3. Mbajtësit e licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv ofrojnë aksesin për transmetim në rrjetin numerik, mbi bazën e marrëveshjeve tregtare me OSHMA-të.

4. AMA siguron që të gjitha shërbimet që u ofrohen OSHMA-ve, që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe ose licencë shërbimi programi audioviziv, nga mbajtësit e licencave numerike të transmetimit audioviziv, bazohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jo diskriminuese.

5. Në rast mosmarrëveshjes midis OSHMA-ve dhe mbajtësve të licencave të transmetimeve numerike audiovizive, palët i drejtohen AMA-s.

KREU II

LICENCIMI I TRANSMETIMEVE AUDIOVIZIVE NUMERIKE DHE SHËRBIM PROGRAMI AUDIOVIZIV

Seksioni I

Kriteret për dhënien e Licencës së transmetimit audioviziv dhe shërbim programi audioviziv

Neni 8

Kërkesa të përgjithshme të aplikimit për licencë transmetimi audioviziv dhe shërbim programi audioviziv

1. Aplikimi për marrjen e licencës së transmetimit audioviziv dhe shërbim programi audioviziv duhet të përmbajë:

- a. Emërtimin, vendndodhjen, formën ligjore të subjektit që bën kërkesën bashkë me emrin dhe firmën e personit që ka të drejtë ta përfaqësojë atë.
- b. Dokumentet që vërtetojnë të dhëna mbi kapitalin financiar të personit juridik që bën kërkesën.
- c. Parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat, origjinën dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen për të cilën kërkohet licenca.
- d. Emërtimin e programit
- e. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, të dhëna për kohëzgjatjen e programeve dhe territorin që do të mbulojë, si dhe projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave.
- f. Listën e administratorëve,
- g. Listën emërore të anëtarëve të bordit drejtues dhe *curriculum vitae* të tyre.
- h. Përmbajtjen e programeve që do të transmetohen dhe strukturën programore të propozuar për transmetim, të cilat të shprehin qartë pluralizmin në tërësinë e tyre dhe paanësinë e informacionit.

- i. Aplikimi duhet të përfshijë informacion mbi strukturën e pronësisë së kompanisë dhe aksionarëve të saj.
- j. Aplikanti duhet t'i përgjigjet çdo pyetjeje të autoritetit rregullator gjatë shqyrtimit të aplikimit.

Neni 9

Kërkesa për pronësinë e subjektit aplikues për licencë transmetimi audioviziv dhe shërbim programi audioviziv

1. Licenca kombëtare e transmetimit audioviziv u jepet shoqërive aksionare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.
2. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri aksionare janë nominative.
3. Në kuptim të këtij neni, aksionar konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat e lidhur me të deri në shkallën e dytë.
4. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare transmetimi audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audioviziv. Për transmetimet analoge audioviziv lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10 për qind në një shoqëri të tretë kombëtare.
5. Kushteve të mësipërme u nënshtrohen edhe licencat kombëtare për shërbimin e programit audioviziv.
6. Licenca kombëtare transmetimit audioviziv nuk u jepet subjekteve që u është hequr ose u është bërë e pavlefshme licenca, me vendim të AMA-s, nëse nuk ka kaluar të paktën një periudhë 10-vjeçare nga data kur i është hequr licenca e transmetimit. I njëjti kufizim zbatohet edhe ndaj subjekteve juridike, aksionare të të cilëve janë individë që kanë qenë aksionarë në subjektet të cilëve iu është hequr licenca me vendim të AMA-s.
7. Licenca kombëtare transmetimit audioviziv nuk u jepet personave të dënuar për një vepër penale, nëse nuk kanë kaluar 5 vjet nga përfundimi i këtij dënimi.
8. Në të njëjtën procedurë, gare, të shpallur nga AMA sipas kësaj rregullore subjekti aplikues mund të marrë pjesë vetëm njëherë. Përfshirë këtu marrjen pjesë të subjekti edhe si palë ose nëpërmjet shoqëri/ve të lidhura me të, shoqëri të kontrolluar, ortakëri, palë e kontraktuar apo nënkontraktor, ofrues shërbimi rrjeti ose pjesë të vet subjektit aplikues.
9. Mosrespektimi i kërkesave sipas këtij neni është kusht skualifikimi.

Neni 10

Kërkesat financiare

1. Licenca kombëtare e transmetimit audioviziv u jepet shoqërive aksionare që kanë kapital të deklaruar e të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në vlerën jo më pak se 3,500,000 lekë.
2. Licenca kombëtare e shërbimit të programit audioviziv u jepet shoqërive aksionare që kanë kapital të deklaruar e të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në vlerën jo më pak se 3,500,000 lekë.
3. Subjekti aplikues:
 - 3.1. Për licencë transmetimi audiovizive duhet të paraqesë garanci bankare në masën e pagesës vjetore të miratuar nga AMA për këtë lloj licence. Shuma e vendosur si garanci do të mbetet e ngurtësuar për një periudhë 24 mujore duke filluar nga data e depozitimit të aplikimit.
 - 3.2. Për licencë për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv duhet të paraqesë garanci bankare në masën e pagesës vjetore të miratuar nga AMA për këtë lloj licence. Shuma e vendosur si garanci do të mbetet e ngurtësuar për një periudhë 18 mujore duke filluar nga data e depozitimit të aplikimit.
 - 3.3. Garancia bankare ç`ngurtësohet menjëherë, para afatit, në rast se subjektit i është refuzuar aplikimi për licencë.
4. Në rast se aplikuesi pajiset me licencë, vlera e ngurtësuar kalon menjëherë për llogari të AMA-s si pagesë për vitin e parë të licencimit.

Neni 11

Kërkesat programore

1. Aplikuesi për licencë kombëtare, të transmetimit audioviziv dhe aplikuesi për licencë kombëtare të shërbimit të programit audioviziv, duhet të garantojë, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, se në përmbajtjen e programeve të tij do të përmbushë standardet programore duke:
 - a. Nxitur vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe në veçanti të drejtën e shprehjes dhe të informimit.
 - b. Respektuar paanshmërinë, plotësinë e pluralizmin e informacionit. Paraqitjen e fakteve dhe ngjarjeve në mënyrë të ndershme, inkurajimin në formimin e lirë të opinionëve, pa i shërbyer në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie, organizate politike, grupimi ekonomik apo komuniteti e shoqate fetare;
 - c. Respektuar mirëkuptimin dhe bashkekzistencën shoqërore të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë;
 - d. Promovuar kulturën kombëtare shqiptare dhe gjuhën shqipe;
 - e. Promovuar kulturën evropiane, të mbajë në konsideratë nevojën e formimit të opinionit publik për t'u njohur dhe për të kuptuar vlerat dhe traditat evropiane;
 - f. Promovuar kulturën e pakicave kombëtare;
 - g. Ofruar mundësi për promovim të krijuesve të rinj në fushën e muzikës, shfaqjeve teatrore dhe sidomos ato të lidhura me kulturën kombëtare;
 - h. Ofruar një shumëllojshmëri shërbimesh në territorin e RSH-së për kategoritë e ndryshme shoqërore, përfshirë këtu interesat e pakicave;
 - i. Promovuar bashkëpronësinë dhe kolegialitetin në vendimmarrjet editoriale;
 - j. Respektuar dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut;
 - k. Respektuar privatësinë e individit;

- l. Respektuar diversitetin fetar dhe racën;
- m. Respektuar ruajtjen e sekretit të burimeve të informacionit;
- n. Respektuar normat morale dhe etike të shoqërisë;
- o. Respektuar të drejtën e përgjigjes.

Neni 12 **Kërkesat teknike**

1. Aplikuesi për licencë kombëtare të transmetimit audioviziv duhet të plotësojë kërkesat teknike, si më poshtë vijon:
 - a. Planin e frekuencave të rrjetit numerik kombëtar, rajonal ose lokal, të miratuar nga AMA bazuar në Aktet Finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve "Për planifikimin e transmetimeve numerike tokësore në pjesë të rajoneve 1 dhe 3 në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06), ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 9851 datë 26.12.2007;
 - b. Standardet e transmetimit;
 - c. Pikat e transmetimit dhe fuqitë përkatëse të rrezatuara që përcaktojnë zonën e mbulimit;
 - d. Shërbimet e reja;
 - e. Teknologjinë e transmetimit;
 - f. Afatin e përfundimit të ndërtimit të rrjetit i ndarë në faza sipas çdo Allotmenti;
 - g. Kohën e implementimit në DVB-T2 në jo me pak se një Allotment;
2. Aplikuesi për licencë kombëtare të shërbimit të programit audioviziv duhet të plotësojë kërkesat teknike, si më poshtë vijon:
 - a. Standardet e prodhimit;
 - b. Teknologjinë e prodhimit;
 - c. Afatin e daljes në transmetim të programit;

Seksion II

Procedura e dorëzimit të aplikimeve

Neni 13 **Çelja e garës**

1. Subjektet e interesuara për licencë për transmetime audiovizive dhe/ose për licencë për shërbim programi audioviziv të mbështetur në rrjet numerik, paraqesin pranë AMA-s letrën e interesit, ku përshkruhet:
 - Shërbimi i kërkuar (transmetim audioviziv numerik apo shërbim programi numerik).
 - Shërbimet e programeve që do të mbështeten në rrjetin numerik, programet që do të transmetohen dhe/ose do të ritransmetohen pas licencimit.
 - Prezantim i shkurtër i veprimtarisë së subjektit të interesuar.

2. AMA, me nismën e vet ose me kërkesën e subjekteve të interesuara sipas pikës 1 të këtij neni, duke marrë në konsideratë ekzistencën e frekuencave të lira për transmetimet numerike:
 - a. përcakton zonat përkatëse të mbulimit me programe, shërbime shoqëruese dhe të dhëna të tjera të lidhura me to.
 - b. çel garën për dhënien e licencës së transmetimit audioviziv numerike dhe/ose licencës së shërbimit të programit audioviziv.

3. AMA, në njoftimin për çeljen e garës, përcakton numrin e shërbimeve të programeve audiovizive që do të mbështeten në multipleks, si dhe nëse ndonjë shërbim ekzistues i programeve audiovizive do të mbështetet në rrjetin numerik.

Neni 14

Shpallja e procedurës së licencimit

1. AMA shpall publikisht çeljen e garës për dhënien e licencës së transmetimit audioviziv numerik dhe/ose licencës së shërbimit të programit audioviziv në faqen e internetit të AMA-s, në tre nga gazetatat me tirazh më të lartë dhe në organet e shtypit.
2. Njoftimi për shpalljen e garës përfshin ftesën e të gjitha palëve të interesuara për të shprehur propozimet e tyre, në lidhje me natyrën e transmetimit audioviziv, për të cilën është çelur gara. Në njoftim përcaktohen procedurat që duhen ndjekur për bërjen e aplikimit dhe kërkesat përkatëse.
3. Aplikimet për licencë bëhen brenda 40 ditëve nga shpallja e garës dhe duhet të përshkruajnë mënyrën e planifikuar të ofrimit të shërbimit dhe plotësimit të kriterëve të shpallura paraprakisht nga AMA.

Neni 15

Tërheqja e dokumentacionit të konkurrimit

1. Subjektet e interesuara për t'u pajisur me licencë transmetimi audiovizive numerike dhe/ose licencës së shërbimit të programit audioviziv duhet të pajisen me dokumentacionin e licencimit dhe të paraqesin aplikimin përkatës në vendin, datën dhe orën e përcaktuar në njoftimin për shpalljen e garës.

2. Drejtoritë e AMA-s, përgatisin dokumentacionin që do t'u vihet në dispozicion subjekteve që do shfaqin interes për t'u licencuar, i cili mund të tërhiqet prej tyre pranë zyrës së protokollit të AMA.

Neni 16

Sqarimet mbi dokumentacionin e licencimit

1. Jo më vonë se 20 ditë përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të aplikimit, subjektet e që kanë blerë dokumentacionin e konkurrimit mund të kërkojnë sqarime me shkrim nga AMA për dokumentacionin e licencimit.
2. Sqarimet e bëra nga AMA mbi dokumentacionin e licencimit, pavarësisht kërkesës së një ose më shumë subjektsh, do t'u njoftohen të gjithë subjekteve që kanë blerë dokumentacionin e licencimit dhe do të publikohen në faqen zyrtare të AMA-s.

Neni 17

Aplikimi

1. Aplikimi duhet të përgatitet në përputhje me kërkesat e publikuara në dokumentacionin e licencimit dhe modelit të miratuar nga AMA, që do të jetë pjesë e dokumentacionit të licencimit.
2. Subjekti aplikues plotëson vetëm hapësirat e modelit të përcaktuara për t'u plotësuar me të dhëna. Subjekti aplikues nuk duhet të bëjë asnjë ndryshim në përmbajtjen e modelit të miratuar.
3. Dokumentacioni i aplikimit që merret në institucionet shtetërore, duhet të jetë marrë jo më vonë se 30 ditë përpara datës së aplikimit.
4. Aplikimi duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit.
5. Dokumentacioni i aplikimit nuk i kthehet aplikuesit.

Neni 18

Dokumentacioni i aplikimit

1. Subjekti aplikuesi për licencë kombëtare transmetimi audioviziv duhet të plotësojë kërkesat për kualifikim si më poshtë:

1.1 Të dhënat e aplikuesit:

- a. Regjistrimi në QKB me gjithë ndryshime (nëse ka), forma ligjore, emërtimi i subjektit, lista e aksionarëve me kuotat përkatëse;
- b. Në rastin kur njëri nga ortakët e subjektit aplikues është person juridik duhet të paraqesë listën e ortakëve të tij;
- c. Deklaratë noteriale të secilit prej aksionarëve të subjektit aplikues, lidhur me aksionet e zotëruara prej tyre në shoqëri të tjera me veprimtari audio ose audiovizive.
- c. Vërtetim i gjendjes gjyqësore të aksionareve të subjektit;
- ç. Adresa, nr. tel, fax, email)
- d. Personi përfaqësues.

1.2 Kërkesa teknike:

- a. Përshkrim të përgjithshëm të shërbimit që kërkohet të ofrohet.
- b. Projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave, shoqëruar me bllokskemat të cilat paraqesin realizimin e shërbimit deri tek përdoruesi fundor.
- c. Listën e pajisjeve teknike që do të përdoren për ofrimin e shërbimit, tipin dhe karakteristikat teknike të tyre.

- ç. Fazat e implementimit të projektit për realizimin me mbulim të zonës së shërbimit
- d. Projektin e studios së prodhimit shoqëruar me bllokskemën e funksionimit të studios
- e. Treguesit e cilësisë së shërbimit, kualiteti i mbulimit dhe cilësia e programeve nga pikëpamja teknologjike, shërbimet e reja shoqëruese dhe të dhëna të tjera të lidhura me to.
- f. Plani i mirëmbajtjes së rrjetit duke përfshirë masat për sigurimin e vazhdimësisë së transmetimeve në raste të shkëputjes së energjisë apo defekteve teknike të mundshme.

1.3 Kërkesat ekonomike:

- a. Të dhëna për kapitalin e deklaruar dhe të nënshkruar të shoqërisë, i cili duhet të jetë i pasqyruar dhe i depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- b. Biznes plani me treguesit e tij dhe analizat përkatëse për periudhën e vlefshmërisë së licencës (a. përshkrimi i shoqërisë, b. analiza e tregut, c. strategjia e marketingut, d. burimet e financimit dhe objektivat financiare);
- c. Garancia bankare që vërteton se aplikuesi ka ngurtësuar shumën në vlerën e vitit të parë të licencimit: deri në 24 muaj për aplikimet për licencë kombëtare duke filluar nga data e paraqitjes së aplikimit;
- ç. Në rastin e aplikimit për licencë për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv duhet të paraqesë garanci bankare deri në 18 muaj në vlerën e vitit të parë të licencimit, duke filluar nga data e paraqitjes së aplikimit;
- d. Parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat, burimet dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen për të cilën kërkohet licenca;
- e. Lista e administratorëve.

1.4. Kërkesat programore:

- a. Përmbajtja e programeve që do të transmetohen dhe strukturën programore të propozuar për transmetim, të cilat të shprehin qartë pluralizmin në tërësinë e tyre dhe paanësinë e informacionit.
- b. Të dhëna statistikore për programet audioviziv të katalogut të shërbimit programor të përgjithshëm dhe tematike (Informacion, kulturë, art, argëtim, zbavitje, radio-dramatizim, sport, emisione për fëmijë, reklamë, etj.)
- c. Të dhëna për kohëzgjatjen e programeve;
- ç. Programi javor i transmetimit;
- d. Përshkrim i shkurtër i përmbajtjes së programeve kryesore të prodhuara vetë;
- e. Veprat audiovizive evropiane që parashikohet të transmetohen.
- f. Depozitimi i kontratave ose marrëveshjeve paraprake me mbajtësit e të drejtave të përmbajtjes që do të transmetohen dhe ritransmetohen.

1.5 Të tjera:

- a. Të dhëna mbi numrin e punonjësve që parashikon të punësojë;
- b. Deklarata për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura;
- c. Informacion mbi struktura e pronësive së kompanisë dhe aksionerëve të saj;
- d. Organizimi dhe drejtimi i shoqërisë, lista dhe CV-të e anëtarëve të Bordit (minimumi 9 anëtarë);

2. Aplikuesi për licencë kombëtare të shërbimit të programit audioviziv, duhet të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara pikat 1.1, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të këtij neni, si dhe kërkesat e mëposhtme teknike:

- a. Përshkrim të përgjithshëm të shërbimit.
- b. Projektin e studios së prodhimit shoqëruar me bllokskemën e funksionimit të studios.
- c. Listën e pajisjeve teknike që do të përdoren për ofrimin e shërbimit
- d. Afatin e daljes në transmetim.
- e. Treguesit e cilësisë së shërbimit (SD, HD, etj.)
- f. Shërbimet e reja shoqëruese

3. Deklarimet e subjektit aplikues mbi plotësimin e kërkesave të parashikuara në këtë nen do të jenë pjesë e kushteve të licencës, mospërbushja e të cilave do të përbëjë shkak për heqjen e saj.

4. Subjekti aplikues duhet t'i përgjigjet çdo pyetjeje të autoritetit rregullator gjatë shqyrtimit të aplikimit.

5. Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme është kusht skualifikues.

Seksioni III

Shqyrtimi dhe vendimmarrja mbi aplikimet

Neni 19

Shqyrtimi i aplikimeve

1. Shqyrtimi i aplikimeve për marrje licence kryhet nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, i ngritur me urdhër të kryetarit të AMA-s.

2. Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit përbëhet si më poshtë:

- Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Licencave
- Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Frekuencave dhe Teknologjisë së Informacionit
- Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme
- Drejtori i Drejtorisë të Programeve
- Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
- Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes

3. Mbledhjet e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit drejtohen nga Zv/Kryetari në cilësinë e Kryetarit të Komisionit, pa të drejtë vote, me pjesëmarrjen e të paktën një prej anëtarëve të AMA-s.
4. Anëtarët e Komisionit shqyrtojnë dhe verifikojnë përmbushjen e kriterëve ligjore, ekonomike, teknike, programore, strukturore dhe përgatisin relacionet e vlerësimit sipas kompetencës. Rezultatet e vlerësimit me pikë i paraqiten AMA-s në një raport të shoqëruar nga një tabelë përmbledhëse ku aplikuesit renditen sipas numrit maksimal të pikëve të grumbulluara.
5. AMA miraton procedurat e ndjekura dhe vlerësimin me pikë në një mbledhje të veçantë. AMA në rast se konstaton mangësi në respektimin e procedurave dhe vlerësimit, ka të drejtë të drejtë të kërkojë kryerjen e një vlerësimi të ri.
6. Anëtarët e Komisionit mbajnë përgjegjësi për saktësinë e përpunimit të të dhënave të akteve të sipërcituara, si dhe për ruajtjen e konfidencialitetit të informacioneve me të cilat njihet gjatë këtij procesi.
7. Informacionet në lidhje me shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve nuk duhet t'u bëhen të njohura aplikuesve a personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces.

Neni 20 Vendimmarrja

1. Vendimi për dhënien ose mosdhënien e licencës së transmetimit audioviziv ose shërbimit të programit audioviziv jepet nga AMA jo më vonë se 60 ditë nga dita e aplikimit.
2. Kur AMA vendos mosmiratimin e aplikimit, duhet të njoftojë aplikuesit për:
 - a) arsyet e vendimit;
 - b) rezultatin e vlerësimit të aplikuesit;
 - c) rezultatin e aplikimit fitues.
3. Kundër vendimit të AMA-s sipas këtij neni, aplikuesi mund të bëjë ankim në gjykatë, në përputhje me rregullat e parashikuara nga ligji për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative duke filluar ky afat nga momenti i marrjes në dijeni.

Seksioni IV

Kriteret e vlerësimit të aplikimeve

Neni 21

Kriteret e vlerësimit të aplikimeve për licencë transmetimi audioviziv

Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit bën vlerësimin me pikë të çdo aplikimi për licencë transmetimi kombëtare audioviziv duke u mbështetur në këto kriterë:

1. Vlerësimi i kompozimit të programeve të veta, 50 (pikë)

I ndarë sipas shërbimit programor:

- | | |
|----------------------|------------------------|
| 1. I përgjithshëm | 6 pikë për 1 program |
| 2. Të Mitur | 4 pikë për 1 program |
| 3. Sport | 3 pikë për 1 program |
| 4. Filma | 3 pikë për 1 program |
| 5. Shqip | 3 pikë për 1 program |
| 6. Programe të tjera | 1 pikë për çdo program |

1.1. Në rast se vlerësimi del më i lartë se 50 pikë, totali i pikëve do të konsiderohet 50 pikë.

2. Vlerësimi i aftësive teknike 40 (pikë)

2.1. Afati i deklaruar i daljes në transmetim: 10 (pikë)

Për kriterin e afatit të daljes në transmetim njësia matëse do të jetë e shprehur në ditë. Aplikuesi me afatin më të shkurtër të daljes në transmetim do të vlerësohet me 10 pikë, si limiti maksimal i vlerësimit. Vlerësimi i subjekteve të tjerë do të llogaritet duke pjesëtuar numrin e ditëve të rezultuara nga afati i tyre i daljes në transmetim me numrin e ditëve të rezultuara nga subjekti që ka përcaktuar limitin maksimal të vlerësimit. Rezultati i këtij raporti do të shumëzohet me 10.

2.2. Mbulimi i zonës së licencimit me shërbim në afate kohore (10 pikë)

Aplikuesi që do të rezultojë me mbulimin më të madh për vitin e parë të licencimit do të përcaktojë dhe limitin maksimal, i cili do të vlerësohet me 10 pikë. Pikët që do të përfitohen nga subjektet e tjerë do të llogariten me përqindjen që mbulimi i subjekteve përkatës zë në mbulimin e aplikuesit që ka përfituar 10 pikë.

2.3. Cilësia e transmetimit për të gjithë programet që mbështeten në rrjet (HD/SD) (5 pikë)

Aplikuesi që do të rezultojë me numrin më të lartë të programeve HD, do të përcaktojë dhe limitin maksimal të vlerësimit, i cili do të vlerësohet me 5 pikë. Pikët që do të përfitohen nga subjektet e tjerë do të llogariten me përqindjen që numri i programeve HD i deklaruar nga aplikuesit përkatës zë në numrin e programeve HD të aplikuesit që ka përfituar 5 pikë.

2.4. Propozimet për aplikimin e shërbimeve të reja (PVR, PVOD, Interaktiv, Multilanguage EPG/Audio/Subtitles, OTA upgrade) (5 pikë)

Për kriterin e shërbimeve të reja, Aplikuesi që do të rezultojë me numrin më të lartë të shërbimeve të mundësuar , do të përcaktojë dhe limitin maksimal të vlerësimit, i cili do të vlerësohet me 5 pikë. Pikët që do të përfitohen nga subjektet e tjerë do të llogariten me përqindjen që numri i shërbimeve të deklaruara nga aplikuesit përkatës zë në numrin e shërbimeve të aplikuesit që ka përfituar 5 pikë.

2.5. Kapaciteti i transmetimit i lënë në dispozicion të të tretëve (5 pikë)

Aplikuesi që do të rezultojë me kapacitetin më të lartë të lënë në dispozicion të të tretëve do të përcaktojë dhe limitin maksimal, i cili do të vlerësohet me 5 pikë. Pikët që do të përfitohen nga subjektet e tjerë do të llogariten me përqindjen që kapaciteti i lënë në dispozicion të të tretëve nga subjektet përkatës zë në kapacitetin e aplikuesit që ka përfituar 5 pikë.

2.6. Plani i mirëmbajtjes së rrjetit transmetues dhe shërbimi i kujdesit ndaj klientit. (5 pikë)

Aplikuesi që do të rezultojë me numrin më të lartë të punonjësve të angazhuar në mirëmbajtjen e rrjetit transmetues dhe shërbimit të kujdesit ndaj klientit, do të përcaktojë dhe limitin maksimal të vlerësimit, i cili do të vlerësohet me 5 pikë. Pikët që do të përfitohen nga subjektet e tjerë do të llogariten mbi përqindjen që numri i punonjësve të deklaruar nga aplikuesit përkatës zë në numrin e punonjësve të aplikuesit që ka përfituar 5 pikë.

3. Vlerësimi i kriterëve financiarë (10 pikë)

3.1. Fuqia ekonomike e aplikuesit

3.1.1 Kapaciteti mesatar i vetëfinancim për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së licencës sipas planit të biznesit (5 pikë)

3.1.2. Kapaciteti mesatar i financimit nga palë të treta (kredi bankare ose palë të lidhura me subjektin) për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së licencës sipas planit të biznesit

(5 pikë)

Neni 22

Kriteret e vlerësimit të aplikimeve për licencë shërbimi programi audioviziv

Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit bën vlerësimin me pikë të çdo aplikimi për licencë kombëtare të shërbimit të programit audioviziv duke u mbështetur në këto kriterë:

1. Struktura programore

1.1 Program i përgjithshëm	75 pikë
Programe informative	10pikë
Programe për mitur	10pikë
Programe sportive	8 pikë
Programe kulturë	8 pikë
Filma	6 pikë
Programe Muzike	6 pikë

Vlerësimi për secilën nga tematikat e mësipërme do të jetë si më poshtë:

Aplikuesi që rezulton me kohën më të gjatë të transmetimit të tematikës përkatëse vlerësohet me pikët maksimale. Vlerësimi i aplikuesve të tjerë do të llogaritet me përqindjen që koha e transmetimit të tyre zë në raport me kohën e aplikuesit me rezultat maksimal.

1.2. Program tematik:	75 pikë
-----------------------	---------

1.2.1 Vlerësimi i tematikës sipas shërbimit programor	(40 pikë)
---	-----------

a. Të mitur	40 pikë
b. Informative	37 pikë
c. Kulturë dhe Shkencë	34 pikë
d. Filma	31 pikë
e. Sport	28 pikë
f. Shqip	25 pikë
g. Muzikë	22 pikë
h. Programe të tjera	19 pikë për çdo program

1.2.2 Programe të realizuar vetë	20 (pikë)
----------------------------------	-----------

Vlerësimi për secilën aplikues do të jetë si më poshtë:

Aplikuesi që rezulton me kohën më të gjatë të transmetimit të programeve të realizuara vetë vlerësohet me pikët maksimale. Për aplikuesit e tjerë vlerësimi bëhet me përqindjen që koha e transmetimit të tyre zë në raport me kohën e aplikuesit me rezultat maksimal.

1.2.3 Programe në gjuhën shqipe	15 (pikë)
---------------------------------	-----------

Vlerësimi për secilën aplikues do të jetë si më poshtë:

Aplikuesi që rezulton me kohën më të gjatë të transmetimit të programeve në gjuhën shqipe vlerësohet me pikët maksimale. Për aplikuesit e tjerë vlerësimi bëhet me përqindjen që koha e transmetimit të tyre zë në raport me kohën e aplikuesit me rezultat maksimal.

2. Vlerësimi i aftësive teknike (15 pikë)

2.1. Cilësia e programit që do mbështetet në rrjetet numerik (HD dhe SD) (7 pikë)

Aplikuesi që do të prodhojë programe në formatin HD do të vlerësohet me (7 pikë)

Aplikuesi që do të prodhojë programe në formatin SD do të vlerësohet me (5 pikë)

2.2. Afati i propozuar i daljes në transmetim (8 pikë)

Për kriterin e afatit të daljes në transmetim njësia matëse do të jetë e shprehur në ditë. Aplikuesi me afatin më të shkurtër të daljes në transmetim do të vlerësohet me 8 pikë, si limiti maksimal i vlerësimit. Vlerësimi i subjekteve të tjerë do të llogaritet duke pjesëtuar numrin e ditëve të rezultuara nga afati i tyre i daljes në transmetim me numrin e ditëve të rezultuara nga subjekti që ka përcaktuar limitin maksimal të vlerësimit. Rezultati i këtij raporti do të shumëzohet me 8.

3. Vlerësimi i kriterëve financiarë (10 pikë)

3.1. Kapaciteti mesatar i vetëfinansim për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së licencës sipas planit të biznesit (5 pikë)

3.2. Kapaciteti mesatar i financimit nga palë të treta (kredi bankare ose palë të lidhura me subjektin) për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së licencës sipas planit të biznesit (5 pikë)

KREU III

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 23

Autorizimi për shërbimin e aksesit të kushtëzuar

1. Subjekti, i cili do të pajiset me licencë për transmetim audioviziv kombëtar autorizohet për ofrimin e shërbimit të aksesit të kushtëzuar për programet e veta dhe të të tretëve që mbështeten në rrjetin e tij. Ofrimi i shërbimit të aksesit të kushtëzuar të të tretëve programi i të cilëve mbështetet në rrjetin e licencuar, bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shërbimit përkatëse.

2. I autorizuari për shërbimin e aksesit të kushtëzuar nuk lejohet t'u ofrojë shërbimin e aksesit të kushtëzuar subjekteve të palicencuar/autorizuar nga AMA.

3. Ofrimi i shërbimit të aksesit të kushtëzuar kryhet në përputhje me kushtet dhe kriteret e rregullores së miratuar nga AMA, për shërbimin e aksesit të kushtëzuar.

Neni 24

Shërbimet pa pagesë (free-to-air)

I licencuari për transmetim audioviziv kombëtar siguron që të gjithë dekoderët që ofron vetë në shitje të kenë aftësinë të marrin dhe shfaqin transmetimet e hapura (free-to-air) të të gjithë rrjeteve numerike kombëtare, rajonale dhe lokale në një zonë të caktuar. Udhëzuesi elektronik i programeve i inkorporuar në këta dekoderë siguron që shërbimet e hapura të shfaqen në ekran dhe të zgjidhen nga shikuesit pa i detyruar ata të paguajnë ndonjë tarifë. Informacionet që shfaqen në Udhëzuesin Elektronik të Programeve duhet të jenë në gjuhën shqipe.

Neni 25

Afati i licencës së transmetimit audioviziv

1. Licenca kombëtare e transmetimit audioviziv jepet për një afat 15 vjeçar.
3. Licenca kombëtare e shërbimit të programit audioviziv jepet për një afat 15 vjeçar.

Neni 26

Detyrimi për daljen në transmetim

I licencuari për transmetim audioviziv kombëtar duhet të respektojë kërkesën e parashikuar në nenin 69 të ligjit nr. 97/2013, për daljen në transmetim.

Neni 27

Detyrimet financiare

1. Pagesat për marrjen e licencës, pagesat vjetore të licencës, pagesat për përpunimin e dokumentacionit, do të kryhen bazuar në vendimin e AMA për pagesat për licencë dhe pagesë për shërbimet që kryhen nga AMA.
2. Pagesa vjetore për licencë kryhet brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik. Në rastin kur pagesa kryhet pas kalimit të këtij afati, aplikohet një kamatë vonesë në masën 0.1% të vlerës së pagesës vjetore për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 30% e vlerës së detyrimit financiar.

Neni 28

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në përputhje me ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

2. Kjo Rregullore publikohet në faqen zyrtare në internet të Autoritetit të Mediave Audiovizive.